



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**

Numri i lëndës: 2024:006297

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05613555

**CT.nr.2/24**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari G. A, duke vendosur në procedurën jokontestimore, lidhur me propozimin për shqyrtimin e trashëgimisë pas vdekjes së të ndjerit –gjyshit të trashëgimtareve S. G dhe të ndjerit – babait të trashëgimtareve D. V që të dy ish nga fshati Budrikë e Ulët, në procedurën e inicuar për shqyrtimin e pasuris trashëgimore nga propozuesit B. Gj nga P. R.e Serbisë , M. V, dhe Z.V që të dy nga fshati Budrikë Komuna P. - P, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike, me datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. VËRTETOHET** se i ndjeri –gjyshi i trashëgimtareve S.G, ka lindur më dt.01.01.1898 në fshatin L. ndërsa ka vdekur me datën 15.07.1966 në fshatin Budrikë e Ulët, K.P. –P. nga babai V. G, dhe nëna M.G-Gj, dhe i ndjeri –babai i trashëgimtareve D.V ka lindur më datën 21.02.1937, ndërsa ka vdekur me datën 22.01.2008, nga babai S.V dhe nëna C. V.

**II.** Nga pasuria trashëgimore i ndjeri gjyshi S.G ka lënë pronat e paluajtshme-ngastrat kadastrale: P-73603018-00631-0 në sipërfaqe prej 2206m<sup>2</sup> , 00633-0 në sipërfaqe prej 1702m<sup>2</sup>, 00678-0 në sipërfaqe prej 1205m<sup>2</sup> , 00698-0 në sipërfaqe prej 1788m<sup>2</sup>, 00712-0 në sipërfaqe prej 201m<sup>2</sup> , 01244-0 në sipërfaqe prej 1252m<sup>2</sup>, 01252-0 në sipërfaqe prej 1531m<sup>2</sup> , 01384-0 në sipërfaqe prej 1541m<sup>2</sup>, 01390-0 në sipërfaqe prej 1976m<sup>2</sup>, 01504-0 në sipërfaqe prej 647m<sup>2</sup> , 01515-1 në sipërfaqe prej 1001m<sup>2</sup> , 01515-2 në sipërfaqe prej 370m<sup>2</sup> , 01515-4 në sipërfaqe prej 496m<sup>2</sup>, 01515-5 në sipërfaqe prej 305m<sup>2</sup> , 01515-6 në sipërfaqe prej 270m<sup>2</sup> , 01515-7 në sipërfaqe prej 246m<sup>2</sup>, të gjitha në ZK –Partesh, të cilat janë të evidentuara në bazë të qertifikates së pronësisë me nr. të lëndës 165-23 të datës 13.11.2023 në emër të S. Gemri i babës V.

**III.** I ndjeri S.G pas vdekjes së tij, për trashëgimtarë të rendit të parë ligjor kishte lënë: mbesën B. Gj. dhe nipat M. V. dhe Z. V.

**IV.** Për trashëgimtar të vetëm ligjor të kësaj pasurie **SHPALLEN** nipat e trashëgimlënesit M. V dhe Z.V.

**A r s y e t i m**

Në këtë gjykatë me datë 09.01.2024, përfaqesuesi i propozuesve Av.M. M nga Gjilani ka paraqitur propozim për shqyrtimin e pasurisë trashigimore të propozueseve M. dhe Z.V nga fshati Budrikë e Ulët , Komuna P.- P .Në propozim ka theksuar se gjyshi i trashigimtareve S. G ka vdekur me datën 15.07.1966 , duke lënë pas djalin e tij të ndjerin D. V , e i cili ka vdekur gjithashtu me datën 22.01.2008 , duke lënë pas veti vajzen B.Gj dhe djemt M. dhe Z. V .

Masa trashëgimore e cila është objekt i shqyrtimit të trashëgimis, përbëhet nga palujtshmeria e cila është përfshirë në Certifikaten me numër të lëndes 165/23 e datës 13.11.2023, ku evidentohet në emër të gjyshit të trashëgimtareve S. G, ish nga fshati Budrikë e Ulët meqenëse pas vdekjes së S. , djali i tij tani i ndjeri D. V nuk e kishte rregulluar asnjëherë trashëgimin , dhe se tani për trashigimtar të të njëjtit , janë caktuar mbesa B. Gj dhe nipërit M.dhe Z.V.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka caktuar senacë për dt. 23.04.2024, përfaqësuesi i propozuesve ka deklaruar se i sqarojm gjykatës se trashëgimtarët M.dhe Z.V, te njëjtit pranojnë pjesët e tyre trashigimore, pas vdekjes se gjyshit te tyre S. G. dhe babait te tyre i cili ishte trashëgimtar i vetëm i të lartpëmendurit S. G., i cili për trashëgimtar ka lënë M. V , Z. V dhe vajzën B.Gj. B.Gj në bazë të deklaratës së dhëne te noteri, nga përmbajtja e saj shefet se nuk e pranon pjesën e saj të trashëgimisë. Me qense e njëjta mungon , nuk o e pranishme ne seancë , te noteri ka dhen enje autorizim me të cilën e ka autorizuar trashëgimtarin V. M , që në emër te saj ta pranoj vendimin e kësaj gjykate lidhur me rregullimin e kësaj qeshje trashëgimore . Propozoj gjykatës që të administrohen provat që janë bashkangjitur propozimit si dhe më pas të merr deklaratat trashëgimore te trashëgimtarët që janë prezent .

Në procesverbalin e dt.23.04.2024, propozuesit M. dhe Z.V, që të dy kanë dhënë deklarata trashëgimore me të cilat deklarata është pranuar masa e trashëgimisë me ½, të pjesëve ideale sa i përket pasurisë së palujtshme-ngastrave kadastrale të cekura si në propozim dhe ate P-73603018-00631-0 në sipërfaqe prej 2206m<sup>2</sup> , 00633-0 në sipërfaqe prej 1702m<sup>2</sup>, 00678-0 në sipërfaqe prej 1205m<sup>2</sup> , 00698-0 në sipërfaqe prej 1788m<sup>2</sup>, 00712-0 në sipërfaqe prej 201m<sup>2</sup> , 01244-0 në sipërfaqe prej 1252m<sup>2</sup>, 01252-0 në sipërfaqe prej 1531m<sup>2</sup> , 01384-0 në sipërfaqe prej 1541m<sup>2</sup>, 01390-0 në sipërfaqe prej 1976m<sup>2</sup>, 01504-0 në sipërfaqe prej 647m<sup>2</sup> , 01515-1 në sipërfaqe prej 1001m<sup>2</sup> , 01515-2 në sipërfaqe prej 370m<sup>2</sup> , 01515-4 në sipërfaqe prej 496m<sup>2</sup>, 01515-5 në sipërfaqe prej 305m<sup>2</sup> , 01515-6 në sipërfaqe prej 270m<sup>2</sup> , 01515-7 në sipërfaqe prej 246m<sup>2</sup>, të gjitha në ZK –Partesh, Komuna P –P.

Gjykata ka administruar edhe provat siq janë : Aktvdekja e datës 27.11.2023, e përpiluar ne Pasjan ; Certifikata e vdekjes me numër rendor 4 e datës 17.11.2023 lëshuar ne ZGJC-Partesh; Certifikata e vdekjes me numër rendor 158 e datës 24.11.2023 lëshuar ne ZGJC-Graqanicë; Ekstrakti i lindjes ne emër te B.Gj me numër 200-00-3 /2023-26/78757 e datës 22.11.2023; Ekstrakti i lindjes me numër serik E27527062 e datës 24.11.2023 ZGJC-Partesh; Ekstrakti i lindjes me numër serik E27504431 e datës 13.11.2023 ZGJC-Partesh; Certifikata e pronësisë me numër te lendes 165/23 e datës 13.11.2023 në emër të S. G.; Specifikimi per detyrimet tatimore e datës 29.11.2023, lëshuar nga Komuna e Parteshit ; Deklarata me shenjen LRP.nr.131/2023 e datës 15.12.2023;

Pas administrimit të provave dhe deklaratës trashëgimore të dhënë nga trashëgimtarja B. Gj e cila ka hequr dorë nga masa trashëgimore dhe pjesën e saj ua bart vëllëzërve të saj – trashëgimtarëve, gjykata për trashigimtarë të pasurisë së cekur në pikën II të dispozitivit të këtij

aktvendimi në bazë të Ligjit mbi Trashëgimin të Kosovës **shpalli trashëgimtar nipërit M. dhe Z.V që të dy nga fshati Budrig e Ulët K. P. - P**, me nga ½, të pjesës ideale.

Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 9, 11 par.1 të Ligjit mbi Trashëgiminë të Republikës së Kosovës, nenit 171, 164.4 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore të Republikës së Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**CT.nr.2/24 më dt. 24.04.2024**

**Gjyqtari  
G. A**